



PËR NJË TË ARDHME  
TË PASTËR  
FOR CLEANER  
FUTURE



 kurse  
energjinë



K O R P O R A T A  
E N E R G J E T I K E E K O S O V Ë S



RAPORTI VJETOR I GJENDJES NË  
MJEDIS 2022



*KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.*

**KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS  
DIVIZIONI SHËRBIMET E KORPORATËS  
DEPARTAMENTI I MJEDISIT**

# **RAPORTI VJETOR I GJENDJES NË MJEDIS 2022**

### PËRMBAJTJA

Lista e tabelave .....	4
Lista e grafikëve.....	5
Figurat .....	5
Shkurtesat .....	6
Hyrje .....	8
Legjislacioni mjedisor dhe energjetik.....	9
Parathënie .....	10
1.0 Prodhimi i Thëngjillit dhe Djerrinës.....	12
2.0 Prodhimi i Energjisë Elektrike në termocentralet “Kosova-A” dhe “Kosova-” .....	14
2.1 Termocentrali “ Kosova -A” .....	15
2.2 Termocentrali “ Kosova -B” .....	17
2.3. Lëndët e para dhe prodhimi i energjisë elektrike .....	19
2.3.1 Prodhimi i Energjisë Elektrike në Termocentralet e KEK-ut .....	19
2.3.2 Energjia Termike e Termocentralit “Kosova-B” për projektin e Ko gjenerimit.....	25
2.4 Shpenzimi i thëngjillit për prodhimin e energjisë në termocentralet e Kosovës.....	26
2.4.2 HIRI.....	28
2.4.3 SHPENZIMI I UJIT .....	32
2.4.4 Shpenzimi i Kimikateve. ....	33
2.5. Gjendja Mjedisore në Termocentrale .....	34
2.8.Monitorimi i Mbeturinave. ....	38
2.11..Raporti përmbledhës i Termocentraleve.....	40
3.0. Gjendja Mjedisore në Divizionin e Prodhimit të Thëngjillit.....	45
3.10.Mbeturinat në DPQ .....	47
3.11.Kushtet klimatike .....	48
4.0. Aktivitete mjedisore të DRPT .....	51

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022

### Lista e tabelave

- Tab..1 Numri i punëtorëve të angazhuar në KEK
- Tab. 2. Prodhimi i Thëngjillit dhe Djerrinës gjatë vitit 2022 në DPQ:
- Tab. 3 Kapacitetet aktuale gjeneruese të TC-ve, HC-BRE
- Tab.4. Prodhimi i energjisë elektrike në të dy Termocentralet gjatë vitit 2022
- Tab. 5. Orët e punës në dy Termocentralet gjatë vitit 2022:
- Tab. 6 Prodhimi në gjenerator, prodhimi në prag, orët e punës dhe mesatarja e energjisë elektrike dhënë rrjetit nga Termocentrali "Kosova-A", gjatë vitit 2022
- Tab. 7. Prodhimi në gjenerator, prodhimi në prag, orët e punës dhe mesatarja e energjisë elektrike dhënë rrjetit nga Termocentrali "Kosova-B", gjatë vitit 2022
- Tab.8. Prodhimi në gjenerator, prodhimi në prag, orët e punës dhe mesatarja e energjisë elektrike dhënë rrjetit nga Termocentralet "Kosova-A dhe B", gjatë vitit 2022
- Tab. 9. Energjia termike e dhënë nga TC "Kosova B" për Termokos, gjatë vitit 2022
- Tab 10. Shpenzimet mujore të thëngjillit në TC "Kosova-A" dhe TC "Kosova-B" gjatë vitit 2022
- Tab. 11. Prodhimi mujor i hirit në TC "Kosova-A" dhe "Kosova-B" gjatë vitit 2022:
- Tab.12. Sasitë e hirit dhe zgurrës të shitura Sharrcemit dhe Trepçës për vitin 2022:
- Tab. 13. Përgatitja e ujit të de karbonizuar dhe të de mineralizuar në dy termocentralet gjatë vitit 2022
- Tab.14. Harxhimi i kimikateve në të dy termocentralet gjatë vitit 2022
- Tab. 15. Sasitë e shpenzuara të naftës në TC "Kosova-A" dhe të mazutit në TC "Kosova-B" për vitin 2022
- Tabela -16 Vlerat Kufitare të Emisioneve për IDM
- Tabela -17 Vlerat Kufitare të Emisioneve
- Tab.18. Emisionet totale dhe specifike mesatare vjetore për vitin 2022 të matura dhe të llogaritura për TC "Kosova-A" dhe TC "Kosova-B"
- Tab.19. Sasia e mbeturinave metalike në termocentralet e KEK-ut 2022
- Tab.20 Sasia e ujit( $m^3$ ) të shkarkuar nga Miniera në pikat shkarkuese si dhe totali – 2022.
- Tab. 21 Sasia e vajrave të grumbulluara, yndyrës dhe baterive gjatë muajve dhe totali i tyre për vitin 2022 në DPQ.
- Tab. 22 Niveli i reshjeve gjatë muajve t; viti 2022
- Tab.23 vlerat mesatare, maksimale dhe minimale në stacionet monitoruese në DPQ.
- Tab.24 Fidanët e reja të mbjellura në vitin 2022 në parkun KEK II.
- Tab.25 Fidanët në plantacionin KR-2, deponinë e djerrinës Kalaja
- Tab.26. Fidanët në plantacionit SR-1, deponia e djerrinës Jugu
- Tab.27 Monitorimi i plantacionit të Dardhishtës

### Lista e grafikëve

- Grafiku 1. Paraqitja grafike e prodhimit të Thëngjillit si dhe largimit të Djerrinës-2022
- Grafiku 2. Kapacitetet aktuale gjeneruese të TC-ve, HC-BR
- Grafiku 3 Prodhimi i energjisë elektrike në TC-A
- Grafiku 4 Prodhimi i energjisë elektrike në TC-B
- Grafiku .5 Energjia e prodhuar në TC-A dhe TC-B gjatë vitit 2022
- Grafiku 6, Orët e punës për njësi në TC-A
- Grafiku 7, Orët e punës për njësi në TC-B
- Grafiku 8 Prodhimi i energjisë për rrjetë nga TC-“Kosova-A”,
- Grafiku 9 Prodhimi i energjisë për rrjetë nga TC-“Kosova-B”
- Grafiku 10 Prodhimi i energjisë për rrjetë nga TC “Kosova-A dhe B”
- Grafiku 11 Prodhimi i hirit dhe zgurres në TC-“Kosova-A” dhe TC-“Kosova-B”
- Grafiku 12 Emisionet e grimcave, SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> nga TC “Kosova-A”
- Grafiku.13 Emisionet e grimcave, SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> nga TC “Kosova-B”
- Grafiku 14 sasitë e ujit të shkarkuar nga Miniera në pikat e shkarkimit dhe totali i ujit të shkarkuar për vitin 2022.
- Grafiku 15 Lartësia mesatare mujore e të reshurave për vitin 2022 Temperatura - DPQ
- Grafiku 16 Lartësia mesatare mujore e temperaturave për vitin 2022
- Grafiku 17 Lartësia mesatare mujore e temperaturave për vitin 2022

### Figurat

- Figurat 1 pamjet në DPQ-së
- Figurat.2 Termocentrali “Kosova-A”
- Figurat.3. Pamje nga Termocentrali “Kosova -B”
- figura.4. Deponia e Seperacionit TC “Kosova A” (Deponia A)
- figuar.5. Deponia e Seperacionit TC “Kosova-B” (Deponia B)
- Figuarat 6,7,.8,9 dhe 10. Pamje nga deponitë e transportit hidraulik të hirit TC “Kosova-A” dhe TC “Kosova-B”
- Figura 11 Objektit për deponimin e materialeve radioaktive të shpenzua
- Figura 12 Pajisjet donacion për matjen e gazrave të shkarkuar nga burimet e palëvizshme.
- Figura 13,14 Pamjet gjatë matjeve të pluhurit dhe gazrave shkarkuese në TC-A dhe TC-B
- Figuar. 15 Imazhi i skemave të vendmostrimeve të ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe shkarkues të parapara për monitorim në DPQ.
- Figura.16 Imazhi i ujërave shkarkues nga Miniera - DPQ të parapara për monitorim në L. Drenica dhe L. Sitnica.

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022

### SHKURTESAT

AER	Agjencinë Evropian për Rindërtim
AKMRrSB	Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore
A1,A2,A3,A4,A5	Njësitë gjeneruese Termocentrali "Kosova A"
BE	Bashkimi Evropian
B1,B2	Njësitë gjeneruese Termocentrali "Kosova B"
BPK	Bifenileve të polikloruara
CO	Monoksidi i Karbonit
CO <sub>2</sub>	Dyoksidi i Karbonit
CH <sub>4</sub>	Metani
CFBC	Qarkullimi i pluhurit fluid që digjet në vatrën( shtratin) e kaldajës
DPQ	Divizioni i Prodhimit të Thëngjillit në KEK
dBA	Deci bel njësia për matjen e zhurmës
DRPT	Departamenti i Projekteve Mjedisore dhe Ri kultivimin e Tokave
ha	Hektar
J	Jashtë
JP	Jug-Perëndim
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.
KSHM	Katalogu shtetëror i mbeturinave
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
IMD(LCP)	Impiantet e mëdha të djegies (Large Combustion Plants)
LGS	Lënda e grimcuar(e thërrmuar) në suspension
MMPHI	Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MPA	Materialet me Përmbajtje Asbesti
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
B	Brenda
m <sup>3</sup>	metër kub
MW	Megavat
MW hth	Megavat energji termike
MS	Miniera Sipërfaqësore
NH <sub>3</sub>	Amoniaku
NO <sub>x</sub>	Oksidet e Azotit
SMM	Sistemi i Menaxhimit Mjedisor
PKU	Përgatitja kimike e ujit
PTD	Pluhuri total i depozituar
POV	Plani Operativ Vjetor
PMPKX	Platoja për meremetimin e pajisjeve kryesore xehëtare
PKX	Pajisjet kryesore xehëtare
PKZE	Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve (NERP).
DQP(PPC)	Djergia e qymyrit pluhur (pulverised coal combustion)
STEV	Vlera mesatare e koncentrimit (përqendrimit) të gazit mesatarja e 8 orëve
TCA	Termocentrali "Kosova A"
TCB	Termocentrali "Kosova B"
TMD	Teknikat më të mira të disponueshme
PAE(TWA)	Pragu i alarmit të ekspozimit të tërësishëm është tejkaluar
VM	Vendmostrimet
Vm(h/vit)	Vlera mesatare e orëve që mund të tejkalohen brenda një viti
Vmd(24/vit)	Vlera mesatare e ditëve që mund të tejkalohen 24 herë në vit

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022

VPalm	Vlera e pragut të alarmit
VRvit	Vlera e rekomanduar 24 orë në vit
VRm	Vlera e rekomanduar mesatare 24 orë
VMm	Vlera e matur mesatare
VRmax	Vlera maksimale e rekomanduar
VMmax	Vlera maksimale e matur
VKMSH	Vlera kufitare për mbrojtjen e shëndetit
VKM	Vlera kufitare e ekosistemit
VK	Vlerat kufitare
VR	Vlerat e rekomanduara
VRp(d)	Vlera e rekomanduar e pranueshme gjatë ditës
VRp(mb)	Vlera e rekomanduar e pranueshme gjatë mbrëmjes
VRp(n)	Vlera e rekomanduar e pranueshme gjatë natës
VRmax(d)	Vlera e rekomanduar maksimale gjatë ditës
VRmax(mb)	Vlera e rekomanduar maksimale gjatë mbrëmjes
VRmax(n)	Vlera e rekomanduar maksimale gjatë natës
VM	Vlera e matur
Vattenfall	Vattenfall është një kompani suedeze e energjisë
ZI	Zona industriale

### HYRJE

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a. është themeluar në baze të Ligjit Nr. 2008/03-L-087-për Ndërmarrjet Publike, me qëllim të kryerjes së veprimtarisë të mihjes së qymyrit dhe gjenerimit të energjisë elektrike. KEK sh.a. Është ndërmarrja kryesore për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovës. Asetet e KEK-ut janë pronë e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Funkcionet e Korporatës rregullohen përmes politikave të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës.

KEK-u prodhon mbi 95 (%) të sasisë së përgjithshme të energjisë elektrike në Kosovë.

Sipas legjislacionit aktual mjedisor të gjitha subjektet të cilat shkaktjnë ndotjen janë të obligueshme të organizojnë sistem të monitorimit me qëllim të përcjelljes së nivelit të ndotjes dhe të raportojnë rregullisht në institucionet qendrore. Bazuar në këtë MMPH përkatësisht AMMK, aktualisht pranon raporte të rregullta nga vet monitorimi që e realizojnë operatorët ekonomik të KEK-ut.

KEK-u në mënyrë të vazhdueshme përcjellë dhe analizon ndikimin e aktiviteteve vetanake në mjedis. Për gjendjen mjedisore KEK-u rregullisht në mënyrë objektive informon institucionet kompetente shtetërore, institucionet lokale komunale dhe palët e interesuara. Si rrjedhojë e kësaj pune pasoi edhe hartimi i këtij raporti.

### METODOLOGJIA

Rezultatet e paraqitura në këtë Raport janë përmbledhje e raporteve mujore për mjedisin të Sektorëve për Mjedis nëpër Divizione dhe Departamentit të Mjedisit.

Për përgatitjen e Raportit kontribuuan :

Departamenti i Mjedisit, mbështetur në raportet vjetore të:

Sektorit të Mjedisit pranë Divizionit të Prodhimit të Qymyrit,(DPQ)

Sektorit të Mjedisit pranë Divizionit Termocentrali “Kosova-A”,

Shërbimi i Analizave, Termocentrali “Kosova-A”,

Sektorit të Mjedisit pranë Termocentralit “Kosova-B”,

Shërbimi i Analizave Termocentrali “Kosova-B”,

Departamentit për Ri kultivimin dhe Pastrimin e Tokave Degraduese (DRPT)



### LEGJISLACIONI MJEDISOR DHE ENERGJETIK

Ligjet mjedisore që i korrespondojnë funksionimit të sektorit energjetik dhe mjedisor në Republikën e Kosovës kanë për qëllim të rregullojnë dhe garantojnë të drejtën e qytetarëve për furnizim me energji elektrike, dhe të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një ambient me ajër, ujë dhe tokë të pastër duke e mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën dhe florën si dhe vlerat natyrore dhe kulturore të mjedisit.

KEK-u bënë përpjekje që konformë këtij legjislacioni të operoi. Ligjet kryesore dhe nën aktet ligjore që rregullojnë çështjet mjedisore dhe energjetike të aplikueshme janë:

### LIEGJISLACIONI I KOSOVËS, MJEDISI

#### Obligim ligjor:


- ✓ Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit
- ✓ Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- ✓ Ligji Nr. 03/L-043 për Kontrollin dhe Parandalimin e Integruar të Ndotjes
- ✓ Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
- ✓ Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës
- ✓ Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat
- ✓ Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma
- ✓ Ligji Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës
- ✓ Ligji nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor
- ✓ Ligji Nr. 03/L-119 2009 - Ligj për produktet Biocide
- ✓ Ligji Nr. 03/L-104 2010 - Ligj për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare
- ✓ Ligji Nr. 02/L-79 2006 - Ligjin për veprimtaritë hidrometeorologjike
- ✓ Ligji nr. 02/L-26 për Tokën bujqësore,
- ✓ Ligji nr. 05/L-081 për Energjinë
- ✓ Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë elektrike
- ✓ Ligji nr. 04/L-016 për Eficiencën e Energjisë
- ✓ Ligji nr. 05/L-052 për Energjinë Termike
- ✓ Ligji nr. 03/L-163 për Minierat dhe mineralet,
- ✓ Ligji Nr. 04/L - 110 - Ligji për ndërtim
- ✓ Ligji nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore
- ✓ Ligji nr. 05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij

**PARATHËNIE**

Republika e Kosovës është tërësisht e varur nga linjiti, si burim kryesor i energjisë për prodhimin e energjisë elektrike, ngrohjes, etj. Prodhimi i energjisë me linjit përbën rreth 95% të energjisë së prodhuar në Kosovë. Pjesëmarrja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë si energjia hidroelektrike, energjia e prodhuar nga era, fuqia fotovoltaike etj., janë ende të kufizuara dhe konsiderohen si burime plotësuese të energjisë për ta përbushur kërkesën për energji elektrike në Kosovë. Në TC-të e Kosovës (TC “Kosova-A” dhe TC “Kosova-B”) në vit digjen mbi 8 milion ton të linjtit. Duhet bërë përpjekje për zvogëlimin e emisioneve nga TC-të, është më se e domosdoshme të përmirësohen kapacitetet teknike në mënyrë që të përbushen kërkesat e PKZE-së. Republika e Kosovës aspirohet të anëtarësohet në Bashkimin Evropian, prandaj kërkohet që Termocentralet e mëdha me djegie (“TMD”), ti ndërmerin të gjitha masat mjedisore për t’i përbushur standardet mjedisore, Plani Kombëtarë për Zvogëlimin e Emisionit (PKZE-së) është që t’i përbushë vlerat e emisionit të përbajtjes së pluhurit, SO<sub>2</sub>, dhe NO<sub>x</sub>, për Vlerat e kufirit të emisionit (“VKE”) për TMD-së. Prandaj Korporatës Energjetike të Kosovës, si prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në Republikën e Kosovës angazhohet që të krijoj prodhim të qëndrueshëm, të bazuar në kosto me qellim të mbajtjes së qëndrueshmërisë financiare dhe të zhvillimit, duke avancuar kushtet për mjedis, siguri dhe shëndet, mirëmbajtje efektive të aseteve, transparencë, sjellje profesionale dhe etike. Të pranohet nga publiku i gjerë dhe palët tregtare se kompania menaxhohet sipas praktikave më të mira ndërkombëtare për ofrim të shërbimeve të mira, të besueshme dhe konkurruese.

Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, është e organizuar sipas makro skemës organizative të paraqitur më poshtë, fig Nr.1.

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A. – MAKROSKEMA ORGANIZATIVE 2018



Date: 15 prill 2019

*L. Z.*



Versioni zyrtar sipas vendimmarrjes nga Bordi i Drejtorëve dhe kërkesave ligjore

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022

Me një strukturë organizative prodhuese:

**Prodhimi i Qymyrit** : Prodhimi i qymyrit në KEK realizohet në Divizionin për Prodhimin e Qymyrit – DPQ. Në kuadër të këtij Divizioni ekziston : Miniera Sipërfaqësore Sibovci Jug perëndimorë (M.S Sibovc- JP), dhe është pjesë e fushës së Sibovcit. Miniera mbulon një sipërfaqe rreth 4.8 (km<sup>2</sup>).

**Prodhimi i energjisë elektrike**: Prodhimi i energjisë elektrike realizohet në dy termocentrale; Termocentrali “Kosova-A” dhe Termocentrali “Kosova-B”, të ndara në dy divizione. Termocentralet janë sisteme komplekse që përbëhen nga disa tërësi tekniko teknologjike qëllimi i të cilave është shndërrimi i energjisë së burimeve natyrore energjetike në energji termike dhe elektrike.

**Divizioni Termocentrali “Kosova-A”**; përbëhet nga pesë njësi operuese: A1, A2, A3, A4 dhe A5 . Njësia A1 me fuqi prej 65 (MW), njësia A2 me fuqi prej 125 (MW), njësia A3 me fuqi 200 (MW), njësia A4 me fuqi 200(MW) dhe njësia A5 me fuqi prej 210 (MW). Njësitë operuese A3, A4 dhe A5 janë në funksion.

Ndërsa njësitë A1 dhe A2 janë jashtë pune, pa status të definuar për momentin

**Divizioni Termocentrali “Kosova-B”** : përbëhet nga dy njësi operuese : B1 dhe B2, me fuqi të njëjtë 339 ( MW). Të dy njësitë operuese janë në funksion.

### Struktura organizative në Korporatën Energjetike të Kosovës

Korporata Energjetike e Kosovës ,KEK sh.a. Aktivitet parësor ka prodhimin e qymyrit dhe energjisë elektrike. Për të realizuar këtë qëllim është i organizuar në Divizione, Zyra dhe Departamente .

Numri i punëtorëve i angazhuar në KEK është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Korporata Energjetike e Kosovës	Nr i punëtorëve
KEK-Drejtoria	32
Divizioni i Financave	52
Zyra ekzekutive e prokurimit	25
Divizioni Termocentrali “Kosova-B”	465
Sekretariati i Korporatës	21
Divizioni i Prodhimit të Qymyrit	2 110
Operimet	60
Divizioni Shërbimet e Korporatës	82
Divizioni Termocentrali “Kosova-A”	576
Σ	3 423

Tab.Nr.1 Numri i punëtorëve të angazhuar në KEK

## 1.0 PRODHIMI I THËNGJILLIT DHE DJERRINËS



Figurat 1 pamjet në DPQ-së,

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022


Ekspluatimi i thëngjillit në KEK bëhet në Divizionin për Prodhimin e Qymyrit - DPQ. Prodhimi mesatar vjetor në DPQ aktualisht është rreth 8.3 milionë tonë thëngjill në vit. Sipas disa hulumtimeve të bëra llogaritet se në Kosovë ka rezerva gjeologjike të linjtit rreth 12 miliardë tonë.

Përgatitja dhe deponimi i përkohshëm i linjtit për nevojat e KEK-ut bëhet në dy deponi; Deponinë e Seperacionit TC "Kosova - A" dhe Deponinë e Seperacionit TC "Kosova - B".

Gjatë vitit 2022 janë prodhuar: 8,277,694 (t) thëngjill. Ndërsa largimi i Djerrinës për vitin 2022 ka qenë 9,692,074 (m<sup>3</sup>).

Nr.	Muaji	Thëngjilli ( t )	Djerrina ( m <sup>3</sup> )
1	Janar	782,682	760,609
2	Shkurt	780,557	855,214
3	Mars	636,874	977,200
4	Prill	648,845	673,258
5	Maj	694,110	679,570
6	Qershor	591,753	623,188
7	Korrik	636,812	879,432
8	Gusht	573,206	959,903
9	Shtator	844,187	895,655
10	Tetor	755,077	967,309
11	Nëntor	602,479	736,004
12	Dhjetor	731,112	684,732
<b>Totali</b>		8,277,694	9,692,074

Tab. 2. Prodhimi i Thëngjillit dhe Djerrinës gjatë vitit 2022 në DPQ:



Grafiku-1. Paraqitja grafike e prodhimit të Thëngjillit si dhe largimit të Djerrinës-2022

## 2.0 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE NË TERMOCENTRALET E KOSOVËS

Korporata Energjetike e Kosovës , KEK-sh.a., përbëhet prej dy termocentraleve: Termocentrali "Kosova-A" dhe Termocentrali "Kosova-B". Termocentralet janë sisteme komplekse energjetike që përbëhen nga disa tërësi tekniko-teknologjike, qëllimi i të cilave është shndërrimi i energjisë së burimeve natyrore energjetike në energji termike dhe elektrike.

Kosova ka burime të mëdha të qymyrit. Shumica e rezervës gjendet afër Termocentraleve. Për çdo vit më shumë se 8.3 milion ton linjit nxirren për çdo vit, e tërë sasia e linjtit është për konsum të TC "Kosova-A" dhe TC "Kosova-B", një sasi e vogël për nevoja tjera.


Kapaciteti total aktual i gjenerimit të energjisë elektrike në Kosovë është rreth 1,100 MW. Termocentralet (TC) me 960 MW, hidrocentralet (HC) me 75MW dhe HC-të e vogla dhe fuqia e erës me 5MW. Termocentralet marrin pjesë me më shumë se 90%, të kapaciteteve aktuale gjeneruese.

"Kosova-A" dhe TC "Kosova-B" kapaciteti i të cilave nuk është nominal por ai aktual i zhvlerësuar.

Kapacitetet gjeneruese	Viti i lëshimit në punë	Fuqia e instaluar MW	Neto operative MW
A-3	1970	200	144
A-4	1971	200	144
A-5	1975	210	144
Kosova-A		610	432
B1	1983	339	264
B2	1984	339	264
Kosova-B		678	528
HC-të e mdhaja			113.82
HC e vogla			17.64
Centrali elektrik solarfotovoltaik ONIX			0.50
"Kosova-A" + "Kosova-B"			960
HC-të			131.96
			1091.96

Tab. Nr. 3 Kapacitetet aktuale gjeneruese të TC-ve, HC-BRE

### Kapacitetet Gjeneruese Operative



Grafiku Nr.2 Kapacitetet aktuale gjeneruese të TC-ve, HC-BR

## 2.1 TERMOCENTRALI “KOSOVA -A”

Termocentrali “Kosova-A” gjendet 8 (km) larg Prishtinës me lokacion në Kastriot (Obiliq). Termocentrali “Kosova A” përbëhet nga pesë njësi punuese të njohura si : A1, A2, A3, A4 , A5.

Njësia punuese A1 me fuqi prej 65 MW është lëshuar në punë në vitin 1962.

Njësia punuese A2 me fuqi prej 125 MW është lëshuar në punë në vitin 1965.

Njësia punuese A3 me fuqi prej 200 MW është lëshuar në punë në vitin 1970.

Njësia punuese A4 me fuqi prej 200 MW është lëshuar në punë në vitin 1971.

Njësia punuese A5 me fuqi prej 210 MW është lëshuar në punë në vitin 1975.

Tri njësitë punuese A3, A4 dhe A5 janë funksionale. Sipas planit aktual të prodhimit janë në shërbim dhe zakonisht njëra prej tyre është rezervë “e nxehtë” .

Njësitë punuese A1 dhe A2 janë jashtë pune, pa status të definuar.



Figurat 2 Termocentrali “Kosova-A”





### 2.2 TERMOCENTRALI “KOSOVA -B”

Termocentrali “Kosova-B” është termocentrali me mundësi më të mëdha të prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë. Termocentrali “Kosova-B” gjendet 13 (km) larg Prishtinës me lokacion në Kastriot (Obiliq) dhe përbëhet nga dy njësi operuese; B1 dhe B2.

Njësia operuese B1 me fuqi të dizajnuar prej 339 MW është lëshuar në punë në vitin 1983.

Njësia operuese B2 me fuqi të dizajnuar prej 339 MW është lëshuar në punë në vitin 1984.

Në operim janë të dy njësitë operuese.



Figurat 3. Pamje nga Termocentrali “Kosova -B”



## 2.3 . PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE DHE LËNDA E PARË

### 2.3.1 PRODHIMI I ENERGJISË ELKTRIKE NË TERMOCENTRALET E KOSOVËS

Në Termocentralin “Kosova-A” janë në operim tri njësi operuese, me kapacitet projektues prej 610 (MW). Por për shkak të vjetërsisë së njërive operuese, kapaciteti aktual operacional janë më të ulëta, dhe sillet prej 432 MW.

Në Termocentralin “Kosova-B” janë në operim të dy njësitë, me kapacitet fillestar të instaluar prej 339 (MW) secili, në kushtet e tanishme energjia maksimale e prodhuar është 303 (MW). Kapaciteti aktual operacional është më i ulët prej 528 MW.

Si lëndë e parë për prodhimin e energjisë elektrike, termocentralet e përdorin thëngjillin, ujin dhe lëndët tjera sekondare. Thëngjilli gjatë djegies liron energjinë termike, e cila energji mundëson prodhimin e avullit me presion dhe temperaturë të lartë. Avulli i prodhuar pastaj vazhdon rrugën për në turbinë e cila e rrotullon gjeneratorin dhe nga aty përfitohet energjia elektrike. Prodhimi i energjisë elektrike në termocentralet “Kosova-A” dhe “Kosova-B” gjatë vitit 2022, është paraqitë në Tabelën 4.

#### Pasqyrat e prodhimi të energjisë elektrike në Gjenerator për njësi të termocentraleve “Kosova A&B”

Prodhimi i energjisë elektrike TC “Kosova-A” dhe TC “Kosova-B” - 2022								
Termocentralet		TC “Kosova-A” (MWh)				TC “Kosova-B” (MWh)		
Njësitë Operuese		A3	A4	A5	A3,A4,A5	B1	B2	B1,B2
Nr.	Muaji	(MWh)	(MWh)	(MWh)	(MWh)	(MWh)	(MWh)	(MWh)
1	Janar	90720	90478.26	80183	261381	205263	58787	264050
2	Shkurt	8125	98402	87672	194199	176172	177666	353838
3	Mars	106311	101321	65526	273158	197414	196038	393452
4	Prill	103135	81436	0	184571	189188	190185	379373
5	Maj	73795	52234	85805	211834	139641	174488	314129
6	Qershor	38172	35125	99268	172565	187099	197307	384406
7	Korrik	39912	94478	62175	196565	68172	203893	272065
8	Gusht	93109	106987	0	200096	203810	43271	247081
9	Shtator	75847	28201	0	104047	200328	155661	355989
10	Tetor	18347	89525	0	107872	191944	166896	358840
11	Nëntor	100683	101638	0	202321	180499	148520	329019
12	Dhjetor	83348	103530	0	186878	208554	190110	398664
<b>TOTALI</b>		831504	983354	480630	2295488	2148086	1902822	4050908
<b>Totali TCA</b>		2 295 488 (MWh)						
<b>Totali TCB</b>		4 050 908 (MWh)						
Total prodhimi i energjisë elektrike TCA dhe TCB		6 346 396 (MWh)						


Tab.4. Prodhimi i energjisë elektrike në të dy Termocentralet gjatë vitit 2022

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022


Prodhimi vjetor i energjisë elektrike në Termocentralin "Kosova-A" gjatë vitit 2022 ishte 2 295 488 (MWh),

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike në Termocentralin "Kosova-B" gjatë vitit 2022 ishte 4 050 908 (MWh).

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike për termocentralet "Kosova-A" dhe "Kosova-B" ishte 6 346 396 (MWh).




Grafiku 3 Prodhimi i energjisë elektrike në TC-A



Grafiku 4 Prodhimi i energjisë elektrike në TC-B

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022




Grafiku Nr.5 Energjia e prodhuar në TC-A dhe TC-B gjatë vitit 2022

### Pasqyrat e orëve të punës për njësi në termocentralet "Kosova A&B"


Orët e punës në TC "Kosova-A" dhe TC "Kosova-B"								
Njësitë Operuese		TC "Kosova-A" (h)				TC "Kosova-B" (h)		
Nr.	Muaji	A3	A4	A5	Totali TCA	B1	B2	Totali TCB
1	Janar	672	622	572	1866	741	216	957
2	Shkurt	63	672	614	1349	634	643	1278
3	Mars	744	744	474	1962	713	710	1423
4	Prill	720	616	0	1336	678	680	1358
5	Maj	528	379	619	1526	506	628	1135
6	Qershor	288	250	720	1258	693	720	1413
7	Korrik	286	646	456	1388	265	744	1009
8	Gusht	658	744	0	1402	742	164	906
9	Shtator	546	196	0	742	719	706	1425
10	Tetor	137	637	0	774	691	718	1409
11	Nëntor	720	720	0	1440	652	603	1255
12	Dhjetor	594	736	0	1330	744	744	1488
<b>TOTALI</b>		5957	6961	3455	16373	7778	7277	15055
<b>Totali TCA</b>		16 539.2 ( h )						
<b>Totali TCB</b>		14 784.64 ( h )						
<b>TOTALI TCA &amp;TCB</b>		31 323.84 ( h )						

Tab. 5. Orët e punës në dy Termocentralet gjatë vitit 2022:

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022



Grafiku 6, Orët e punës për njësi në TC-A



Grafiku 7, Orët e punës për njësi në TC-B

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022

**Pasqyrat e prodhimi të energjisë elektrike në gjenerator dhe energjisë elektrike dhënë rrjetit nga Termocentrali "Kosova-A"**

<b>Prodhimi në gjenerator, prodhimi në prag, orët e punës dhe mesatarja e energjisë elektrike dhënë rrjetit nga Termocentrali "Kosova-A", gjatë vitit 2022</b>					
<b>2022</b>	Prodhimi ( MWh)	Prodh. në prag.(MWh)	Orët e punës	Prodh.(MWh/ h)	Prodh.për rrjetë(MWh/h)
Janar	261381	229752	1866	351.32	308.81
Shkurt	194199	170997	1349	288.99	254.46
Mars	273158	241584	1962	367.15	324.71
Prill	184571	162885	1336	256.35	226.23
Maj	211834	185661	1526	284.72	249.54
Qershor	172565	150478	1258	239.67	209.00
Korrik	196565	172878	1388	264.20	232.36
Gusht	200096	177378	1402	268.95	238.41
Shtator	104047	90524	742	144.51	125.73
Tetor	107872	94105	774	144.99	126.48
Nëntor	202321	179045	1440	281.00	248.67
Dhjetor	186878	165060	1330	251.18	221.86
Σ(01 - 12)	2295488	2020346	16373	262.04	230.63

Tab. 6 Prodhimi në gjenerator, prodhimi në prag, orët e punës dhe mesatarja e energjisë elektrike dhënë rrjetit nga Termocentrali "Kosova-A", gjatë vitit 2022

**Pasqyrat e prodhimi të energjisë elektrike në gjenerator dhe energjisë elektrike dhënë rrjetit nga Termocentrali "Kosova-B"**

<b>Prodhimi në gjenerator, prodhimi në prag, orët e punës dhe mesatarja e energjisë elektrike dhënë rrjetit nga Termocentrali "Kosova-B", gjatë vitit 2022</b>					
<b>2022</b>	Prodhimi ( MWh)	Prodh. në prag.(MWh)	Orët e punës	Prodh.(MWh/h)	Prodh.për rrjetë(MWh/h)
Janar	264050	239607	956.75	275.99	354.91
Shkurt	353838	322243	1277.74	276.92	526.54
Mars	393452	357823	1422.55	276.58	528.83
Prill	379373	345133	1358.34	279.29	526.91
Maj	314129	285323	1134.62	276.86	422.22
Qershor	384406	348988	1412.57	272.13	533.90
Korrik	272065	246796	1009.43	269.52	365.68
Gusht	247081	224871	906.00	272.72	332.10
Shtator	355989	322752	1425.07	249.80	494.43
Tetor	358840	326088	1408.93	254.69	482.31
Nëntor	329019	299314	1255.31	262.10	456.97
Dhjetor	398664	362502	1488.00	267.92	535.84
Σ(01 - 12)	4050906	3681440	15055.31	269.07	462.43


Tab. 7. Prodhimi në gjenerator, prodhimi në prag, orët e punës dhe mesatarja e energjisë elektrike dhënë rrjetit nga Termocentrali "Kosova-B", gjatë vitit 2022

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022

Pasqyrat e prodhimi të energjisë elektrike në gjenerator dhe energjisë elektrike dhënë rrjetit nga të dy termocentralet.

<b>Prodhimi në gjenerator, prodhimi në prag, orët e punës dhe mesatarja e energjisë elektrike dhënë rrjetit nga termocentralet "Kosova-A dhe B", gjatë vitit 2022</b>					
2022	Prodhimi ( MWh)	Prodh. në prag.(MWh)	Orët e punës	Prodh.(MWh/ h)	Prodh.për rrjete(MWh/h)
Janar	789481	708966	3779	706.22	630.86
Shkurt	901875	815483	3905	815.53	733.99
Mars	1060062	957230	4807	895.98	805.65
Prill	943317	853151	4052	783.26	705.58
Maj	840092	756307	3795	706.94	633.04
Qershor	941377	848454	4083	773.57	693.70
Korrik	740695	666470	3407	629.88	564.08
Gusht	694258	627120	3214	601.04	540.66
Shtator	816025	736028	3592	638.94	573.99
Tetor	825552	746281	3591	627.30	564.78
Nëntor	860359	777673	3951	737.97	664.39
Dhjetor	984206	890064	4306	787.02	709.09
Σ(01 - 12)	10397300	9383226	46483	724.47	650.89


Tab.8. Prodhimi në gjenerator, prodhimi në prag, orët e punës dhe mesatarja e energjisë elektrike dhënë rrjetit nga Termocentralet "Kosova-A dhe B", gjatë vitit 2022




Grafiku 8 Prodhimi i energjisë për rrjetë nga TC-"Kosova-A",



## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022



Grafiku 9 Prodhimi i energjisë për rrjetë nga TC-“Kosova-B”



Grafiku 10 Prodhimi i energjisë për rrjetë nga TC “Kosova-A dhe B”

### 2.3.2 ENERGJIA TERMIKE E TERMOCETRALIT “KOSOVA-B” PËR PROJEKTIN E KOOJENERIMIT

Energjia termike e bartur në “Ngrohtoren Termokos” sh.a. është një shembull i mirë i përmirësimit mjedisor.

Ky projekt përfshinë lidhjen e sistemit të ngrohjes qendrore të qytetit të Prishtinës me TC “Kosova-B” përmes ngrohjes së ujit të Ngrohtores së qytetit me avullin e termocentralit.

#### Pasqyrat e energjisë termike dhënë Termokosit

Energjia termike e dhënë nga TC “Kosova B” për Termokos ( MWh-energji termike)			
Njësia Operuese	B1	B2	Njësia
Sasia	150303	140242	(MWh-eth)
Totali	290545		(MWh-eth)

Tab. 9. Energjia termike e dhënë nga TC “Kosova B” për Termokos, gjatë vitit 2022

## 2.4 SHPENZIMI I THËNGJILLIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË NË TERMOCENTRALET E KOSOVËS

Thëngjilli si lëndë e parë djegëse në termocentralet e Kosovës gërmohet në pjesën jugperëndimore të Fushës së Sibocit nga Miniera Sipërfaqësore Sibovci Jugperëndimor (M.S - JP). Thëngjilli i Kosovës i takon llojit të linjiteve dhe ka ngjyre të zezë (të errët). Gërmimi i linjtit dhe heqja e djerrinës organizohet si proces i vazhdueshëm teknologjik, që përbëhet nga dy aktivitete prodhuese: heqja e djerrinës dhe ekskavimi i thëngjillit.

Thëngjilli pasi të nxirret me eskavator rotorik (me sistem kontinual, eskavimi, shirita transportues, etj.), me anë të shiritave transportues transportohet deri në Deponinë e Seperacionit TC "Kosova A" (Deponia-A), gjegjësisht Deponinë e Seperacionit TC "Kosova B" (Deponia-B).

Në Termocentralin TC "Kosova A", sasi të thëngjillit për djegie në njësitë prodhuese për nevojat e prodhimit nuk maten, prandaj edhe sasi të llogaritura të thëngjillit për prodhimin e energjisë elektrike nëpër njësi, merren nga matjet fotogrametrike të realizuara në DPQ.



fig.4. Deponia e Seperacionit TC "Kosova A" (Deponia A)



fig.5. Deponia e Seperacionit TC "Kosova-B" (Deponia B)

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022

Seperacionet janë ura lidhëse në mes të minierave dhe termocentraleve. Aty bëhet thërrmimi i copave të thëngjillit për termocentrale me granulacion prej 0 ÷ 30 (mm). Pas thërrmimit, thëngjilli përmes shiritave përcillet në bunker (fortinë), prej nga me anë të dhënëseve të thëngjillit dërgohet në mulli për bluarje, dhe së fundi përcillet në vatrat e kaldajave të termocentraleve.

### Pasqyrat e harxhimit mujor të linjtit për njësi prodhuese të termocentraleve "Kosova-A&B"

		Harxhimet mujore të linjtit për TC "Kosova-A" dhe TC "Kosova-B"								
		Harxhimi Mujor (t)				H.Spec(t/MW)	Harxhimi Mujor (t)			H.Spec(t/MW)
Njësitë punuese		A3	A4	A5	A3, A4, A5	A3, A4, A5	B1	B2	B1&B2	B1&B2
1	Janar	137894	137527	121878	397299	1.52	263757	70607	334364	1.27
2	Shkurt	12350	149570	133262	295183	1.52	218442	204973	423415	1.20
3	Mars	161593	154007	99600	415200	1.52	241952	225387	467339	1.19
4	Prill	156765	123783	0	280549	1.52	236584	213442	450026	1.19
5	Maj	112169	79396	130424	321988	1.52	177331	194993	372324	1.19
6	Qershor	58021	53390	150887	262299	1.52	233586	220530	454116	1.18
7	Korrik	60666	143606	94506	298779	1.52	83935	229043	312978	1.15
8	Gusht	141526	162620	0	304146	1.52	247616	50135	297751	1.21
9	Shtator	115287	42865	0	158152	1.52	248397	177786	426183	1.20
10	Tetor	27888	136078	0	163966	1.52	240769	188750	429519	1.20
11	Nëntor	153038	154489	0	307528	1.52	219530	172500	392030	1.19
12	Dhjetor	126689	157365	0	284054	1.52	261623	225380	487003	1.22
Totali/Mes.		1263886	1494698	730557	3489142	1.52	2673522	2173526	4847048	1.20
<b>Totali i Harxhimit TCA (t)</b>		3,557,071								
<b>Totali i Harxhimit TCB (t)</b>		4,847,049								
<b>Totali i Harxhimit TCA + TCB (t)</b>		8,404,120								

Tab 10. Shpenzimet mujore të thëngjillit në TC "Kosova-A" dhe TC "Kosova-B" gjatë vitit 2022

Termocentrali "Kosova-A" gjatë vitit 2022 ka shpenzuar 3 557 071 (t) thëngjill, 1.52 (t/MWh). Termocentrali "Kosova-B" gjatë vitit 2022 ka shpenzuar 4 847 049 (t) thëngjill, 1.20 (t/MWh). Harxhimi i thëngjillit gjatë vitit 2022, për të dy Termocentralet ka qenë 8 404 120 (t) dhe mesatarisht janë shpenzuar rreth 1.35( t/MWh).

### 2.4.2 HIRI

Gjatë procesit të djegies në kaldajë, hirin prodhohet si hi fundërrues, hi fluturues dhe zgurrë(zgjyrë). Sasia e prodhuar e hirit nga përmbajtja e materieve jo djegëse në thëngjill, materieve inorganike. Hiri dhe Zgurra nga termocentralet deponohen me anë të sistemit për bartjen e hirit në mënyrë hidraulike në vendet e boshatisura të minierës së Mirashit.


#### Pasqyrat e prodhimit të hirit gjatë vitit 2022 nga TC "Kosova-A" dhe TC "Kosova-B".

Prodhimi i hirit në TC "Kosova-A" dhe TC "Kosova-B"					
Njësitë punuese		TC-A		TC-B	
Nr.	Muaji	Prodhimi i hirit (t)	Prodhimi Specifiki hinit (t/MWh)	Prodhimi i hirit (t)	Prodhimi Specifiki hinit (t/MWh)
1	Janar	60045	0.23	49503	0.19
2	Shkurt	44612	0.23	60400	0.17
3	Mars	62751	0.23	65124	0.17
4	Prill	42400	0.23	65591	0.17
5	Maj	48663	0.23	55942	0.18
6	Qershor	39642	0.23	62259	0.16
7	Korrik	45155	0.23	47432	0.17
8	Gusht	46641	0.23	45660	0.18
9	Shtator	23673	0.23	61292	0.17
10	Tetor	23291	0.22	61013	0.17
11	Nëntor	41163	0.20	52473	0.16
12	Dhjetor	40506	0.22	69447	0.17
Totali		517402	0.23	698931	0.17
<b>Totali i Prodhimit te hiri+zgurrë në TCA &amp;TCB (t)</b>				1216333	
<b>Mesatarja e Prodhimit specifik te hirit+zgurrë në TCA (t/MWh)</b>				0.198	

Tab. 11. Prodhimi mujor i hirit në TC "Kosova-A" dhe "Kosova-B" gjatë vitit 2022:

Në Termocentralin "Kosova-A" gjatë vitit 2022 janë prodhuar : 517 402 (t), :0.23 (t/MW).  
 Në Termocentralin "Kosova-B" gjatë vitit 2022 janë prodhuar : 698 931 (t). : 0.17 (t/MW).  
 Gjatë vitit 2022 sasia e përgjithshme e hirit të prodhuar në Termocentralet "Kosova-A" dhe "Kosova-B" ishte: 1 216 333 (t). Ndërsa mesatarja e prodhimit specifik të hirit ishte: 0.198 (t/MW).

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022



Grafiku 11 Prodhimi i hirit dhe zgurres në TC-“Kosova-A” dhe TC-“Kosova-B”





Fig.6,7,8,9 dhe 10. Pamje nga deponitë e transportit hidraulik të hirit TC "Kosova-A" dhe TC "Kosova-B"

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022

Termocentrali “Kosova-B” dhe Termocentrali “Kosova-A”, vartësisht prej kërkesave e bëjnë shitjen e hirit dhe zgurës. Sasia e hirit dhe zgurës që i është shitur Sharr cemit dhe Trepçës për vitin 2022 është dhënë në tabelën e më poshtme:

### Sasia e hirit dhe zgurës e shitur Sharrcemit dhe Trepçës gjatë vitit 2022:

Pasqyrat e shitjes së Hirit dhe Zgurës SHARRCEMIT dhe TREPÇËS nga termocentralet “Kosova A&B”, për vitin 2022

Raporti i shitjes së Hirit dhe Zgurës SHARRCEMIT dhe TREPÇËS për vitin 2022				
Viti 2022	SHARRCEMI-HI (TC-A+TC-B)	SHARRCEMI-Zgurë (TC-A+TC-B)	Viti /2021	TREPÇA-HI
Muaji	HI / ton	ZGURRE / ton	Muaji	HI / ton
Janar	464	0	Janar	0
Shkurt	2308.52	0	Shkurt	94.18
Mars	8084.93	0	Mars	789.84
Prill	8347.86	545.38	Prill	1094.26
Maj	9308.58	1069.64	Maj	1356.24
Qershor	9040.72	1122.12	Qershor	1439.28
Korrik	9018.46	1067.5	Korrik	357.5
Gusht	10367.4	1271	Gusht	443.76
Shtator	11170.82	1256.18	Shtator	1108.92
Tetor	10690.98	118.62	Tetor	1031.96
Nëntor	10281.26	4206.5	Nëntor	1986.72
Dhjetor	6836.28	490.36	Dhjetor	700.88
Total / Ton	95 919.81	12 217.3	Total / Ton	10 403.54
Gjithsejtë	HI dhe Zgurë	118 540.65		

Tab.12. Sasi të hirit dhe zgurës të shitura Sharrcemit dhe Trepçës për vitin 2022:

Sasia e hirit dhe zgurës që i është shitur Sharrcemit dhe Trepçës për vitin 2022, ishte:  $95\,019.81 + 10\,403.54 = 106\,323.35$  (t) hi dhe  $12\,217.3$  (t) zgurë, gjithsejtë hi + zgurë =  $118\,540.65$  (t). Sasi të shitura të hirit dhe zgurës gjatë vitit 2022 është 8.74 % e sasisë së përgjithshme të hirit dhe zgurës së prodhuar gjatë vitit.

### 2.4.3 SHPENZIMI I UJIT

Termocentralet e Kosovës furnizohet me ujë të papërpunuar nga lumi Llap dhe Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër -Lepenc" sh.a.

Uji i papërpunuar përdoret si lëndë e parë për përfitim të avullit dhe si medium ftohës për pajisjet dhe stabilimente termoenergjetike. Sasia e ujit që përdoret në termocentrale për përfitimin e avullit teknologjik dhe për ftohje, më parë duhet ti nënshtrohet procesit kimik të përpunimit, zbutjes respektivisht de karbonizimit, de mineralizimit, degazimit si dhe kondicionimit kimik. Vetëm uji i përgatitur në këtë mënyrë, mund të përdoret për përfitimin e avullit teknologjik me kritere të lejuara. Termocentrali "Kosova-A" gjatë vitit 2022 ka pranuar ujë të pa përpunuar : 15.768.000 (m<sup>3</sup>), nga sasia e tërësishme e ujit nga lumi llap janë pranuar 14.389.820 (m<sup>3</sup>) ndërsa nga Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër -Lepenc" sh.a. 1.378.180(m<sup>3</sup>). Janë përpunuar 9 958 162 (m<sup>3</sup>) ujë të de karbonizuar, dhe 537 607 (m<sup>3</sup>) ujë të de mineralizuar

Termocentrali 'Kosova-B' gjatë vitit 2022 ka përpunuar 8 431 480 (m<sup>3</sup>) ujë të de karbonizuar, dhe 446 513 (m<sup>3</sup>) ujë të De mineralizuar

#### Pasqyrat e përgatitjes së ujit të de karbonizuar dhe të de mineralizuar në dy termocentralet gjatë vitit 2022 :

Termocentralet		Harxhimi - Uji TC "KOSOVA-A"				Harxhimi - Uji TC "KOSOVA-B"			
Uji		Uji i De-karbonizuar		Uji i De-mineralizuar		Uji i De-karbonizuar		Uji i De-mineralizuar	
Harxhimi		Harxhimi	Harxh. spec	Harxhimi	Harxh.spec.	Harxhimi	Harxh. spec.	Harxhimi	Harxh. spec.
Njësia		(m <sup>3</sup> )	(m <sup>3</sup> /MW)	(m <sup>3</sup> )	(m <sup>3</sup> /MW)	(m <sup>3</sup> )	(m <sup>3</sup> /MW)	(m <sup>3</sup> )	(m <sup>3</sup> /MW)
1	Janar	1050000	4.02	59450	0.23	882600	3.34	31653	0.12
2	Shkurt	882600	4.54	43614	0.22	650300	1.84	38892	0.11
3	Mars	1097276	4.02	60426	0.22	718290	1.83	44335	0.11
4	Prill	694985	3.77	43746	0.24	732300	1.93	38922	0.10
5	Maj	1193577	5.63	51747	0.24	691650	2.20	40221	0.13
6	Qershor	910139	5.27	44803	0.26	867230	2.26	31756	0.08
7	Korrik	1112948	5.66	43405	0.22	643070	2.36	26286	0.10
8	Gusht	668598	3.34	39671	0.20	581580	2.35	27944	0.11
9	Shtator	476935	4.58	31167	0.30	818760	2.30	43340	0.12
10	Tetor	535375	4.96	30023	0.28	756750	2.11	41663	0.12
11	Nëntor	581842	2.88	43605	0.22	673840	2.05	34377	0.10
12	Dhjetor	753887	4.03	45471	0.24	757670	1.90	36984	0.09
Totali		9 958 162	4.34	537 607	0.23	8 431 480	2.08	446 513	0.11
Mesatarja e Harxh. Specifik		3.21				0.1722			
Kriteri		2.1 ÷ 2.6 (m <sup>3</sup> /MW)		0.1 (m <sup>3</sup> /MW)		2.1 ÷ 2.6 (m <sup>3</sup> /MW)		0.06 (m <sup>3</sup> /MW)	
Totali i uji i De karbonizuar TCA & TCB 2022								18 389 642	
Totali i uji i De mineralizuar TCA & TCB 2022								984 120	

Tab. 13. Përgatitja e ujit të de karbonizuar dhe të de mineralizuar në dy termocentralet gjatë vitit 2022



#### 2.4.4 SHPENZIMI I KIMIKATEVE

Në Termocentralet e Kosovës për procesin e prodhimit dhe trajtimit të ujërave industriale përdoren kimikate të ndryshme. Kimikatet si: gëlqerja e hidratizuar, acidi klorhidrik, hidroksidi i natriumit, kougulantë dhe flokulantët dhe në fund ujërat industriale kondicionohen me hidroksid amoni, hidrazin , inhibitorë të korozionit , stabilizatorë të fortësisë si dhe biocide. Të gjitha këto shtohen në sistemin ujë - avull dhe sistemin e ujit të de karbonizuar për ftohje, për të mënjanuar procesin e korozionit dhe depozitues, eliminuar oksigjenin dhe për ta rregulluar pH. Kimikatet e nevojshme për përgatitjen e ujit janë të evidentuar në tabelën e më poshtë .

##### Pasqyrat e harxhimeve të kimikateve gjatë vitit 2022 në termocentralet “KosovaA&B”

Nr.	Emërtimi-Formula-koncentrimi	Njësiti	TC “Kosova-A”	TC “Kosova-B”	Totali (t)
1	Acid klorhidrik (HCl - 30% )	t	597.34	429.01	1026.35
2	Harxhi. spec. i acidit-projektuar(0.41.t/t DM-ujë)	kg/MWh	0.00	0.11	0.11
3	Hidroksid natriumi (NaOH - 40% )	t	502.21	287.7	789.91
4	Harxhi. spec i bazës -NaOH-projektuar(0.31 t/t DM-ujë)	kg/MWh	0.00	0.07	0.07
5	Gëlqere e hidratuar (Ca (OH) <sub>2</sub> - 90%)	t	1832	1518	3350
6	Vargimi spec. I gëlqeres (180 ppm -t/t DK-ujë)	kg/MWh	0.001	0.375	0.375
7	Ferisulfat Fe <sub>2</sub> (SO <sub>4</sub> ) <sub>3</sub> - 50%)	t	18.3	40.72	59.02
8	Koagulant/Katjonik.	kg.	0	6000	6000
9	Hidrazinë/levoksinit (N <sub>2</sub> H <sub>4</sub> - 15%)	t	3.95	24.80	28.75
10	Hidroksid amoni ( NH <sub>4</sub> OH - 25%)	t	0	19.425	19.425
11	INHIBITOR/DISPERZANT.	t	42.3	49.2	91.5
12	Inhibitor për-Cu .	kg.	0	2000	2000
13	Biocid algacid.	kg	0	7000	7000
14	Natrium Hipoklorit 12%.	kg.	0	18996	18996
15	Hidrogjen H <sub>2</sub>	m3N	10306	0	10306
16	Dyoksid i karbonit CO <sub>2</sub>	m3N	19577	0	19577

Tab.14. Harxhimi i kimikateve në të dy termocentralet gjatë vitit 2022:

Si lëndë djegëse sekondare për startim të blloqeve, si dhe për mbajtjen e ngarkesave të prodhimit, në raste të veçanta, në TC “Kosova-A” përdoret nafta, ndërsa në TC “Kosova-B” përdoret mazuti.

##### Pasqyrat e shpenzimeve të naftës dhe mazutit në termocentralet “Kosova A&B”, gjatë vitit 2022.

Njësia Gjeneruese	Shpenzimet e naftës ( lit. )	Harxhimi specifik (l/MWh)
1 TC -A3	852104	1.02
2 TC -A4	548684	0.56
3 TC -A5	323145	0.67
Totali Naftë- TC-A	1723933	0.75
TC Kosova B (t)	Shpenzimet e mazutit ( t )	Harxhimi specifik (kg/MW)
1 TC-B1	1719.64	0.80
2 TC-B1	1387.95	0.73
Totali mazut- TC-B	3107.59	0.77

Tab. 15. Sasitë e shpenzuara të naftës në TC “Kosova-A” dhe të mazutit në TC “Kosova-B” për vitin 2022

### 2.5 Gjendja Mjedisore në Termocentrale

Lëndët djegëse fosile qymyri, nafta dhe derivatet e sajë paraqesin problemet kryesore të ndotjes së mjedisit, me djegin e tyre në atmosferë çlirohen sasi të mëdha të produkteve të djegies – gazrave si SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, CO dhe CO<sub>2</sub>, grimcat e ngurta (hirit fundërrues dhe fluturues ), ndotësit e ndryshëm inorganike dhe organike, si metalet "të rënda", dhe hidrokarbure aromatike policiklike.

Me qëllim të parandalimit dhe kontrollit të ndotjes së mjedisit, Direktivat Evropiane 2001/80 /KE dhe 2010/75/EU mbi emetimet industriale, aplikimet e të cilëve zbatohet në legjislacionin përkatës të Kosovës në fushën e mbrojtjes së mjedisit, përcakton kërkesat e detyrueshme mjedisore që të gjitha termocentralet me imput termik që tejkalojnë 50 MW për të marrë lejet mjedisore të operimit. Direktiva parashikon aplikimin e teknologjisë më të mirë në dispozicion (TMD) dhe masa të tjera që synojnë parandalimin ose, kur kjo nuk është e realizueshme atëherë ti marrë të gjitha masat për veprimet minimale në ndikim mjedis nën vlerat e përcaktuara kufitare të shkarkimeve (VKE), dhe reduktimin e mbeturinave

#### 2.5.1 Emisionet

Qymyri si lëndë djegëse kryesore e Termocentraleve të Kosovës merret nga minierat sipërfaqësore me karakteristika të njohura. Gjatë djegies (oksidimit) së qymyrit si lëndë e parë, në prani të ajrit, lirohen produkte të djegies: CO<sub>2</sub>, CO, SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, H<sub>2</sub>O, N<sub>2</sub>, O<sub>2</sub>, dhe pluhuri si emision.

Në Termocentralet e Kosovës, sasi të emisioneve të gazrave SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe CO<sub>2</sub>, llogariten duke u bazuar në raportet stekiometrike të reaksionit kimik, nga të dhënat për kualitetin e qymyrit dhe harxhimet e qymyrit për prodhimin e energjisë elektrike në gjenerator. Sasi të pluhurit si emision nga blloqet A-3, A-4 dhe A-5, maten në dalje të kanaleve pas fundërruesve elektrostatik, para hyrjes së tyre në tymtar. Vlerat e regjistruara të sasive të pluhurit si emision paraqiten në raportet mujore, për të pasur rezultate të besueshme matësit e pluhurit në kanalet e gazrave duhet të kenë mirëmbajtje të rregullt nga personeli përgjegjës. Duhet shikuar mundësitë e kalibrimit dhe servisimit të këtyre instrumenteve.

Në TC "Kosova-B" për shkak të dizajneve projektuese të fundërruesve elektrostatik, emisioni i grimcave (pluhurit) nuk është në përputhje me standardet që përcaktojnë limitin e emisionit të pluhurit.

Në TC "Kosova-B" janë të vendosur analizatorët (pajisjet) për matjen e vazhdueshme të emisioneve të grimcave: SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe CO<sub>2</sub>. Por të njëjtit për shkak të problemeve teknike dhe me mirëmbajtje nuk janë në funksion.

#### 2.5.2 EMITIMI I DYOKSIDIT TE SULFURIT SO<sub>2</sub>

Emetimi i dyoksidit të sulfurit (SO<sub>2</sub>) varet nga përbërja e sulfurit organik (So) në thëngjill, si dhe nga karakteri alkalik i thëngjillit, respektivisht desulfurimit vetanak i realizuar brenda kaldajës. Në Termocentralet "Kosova-A" dhe "Kosova-B" nuk janë të instaluar desulfuruesit (De-SO<sub>2</sub>). Në mungesë të matjeve emisionet e SO<sub>2</sub> llogariten.

## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022

Sjellja e përbërjes së SO<sub>2</sub> si emision në gazrat e oxhakut është e ndryshueshme kohë pas kohe, kjo varet prej faktorëve të ndryshëm nga përbërja e CaO në hi, temperatura në vatër, shpejtësia e reaksionit etj - De-Sulfurimi vetanak.

### 2.5.3 EMITIMI I NO<sub>x</sub>

Emetimi i NO<sub>x</sub> shkaktohet prej djegies së azotit të përmbajtur në thëngjill dhe nga prania e azotit në ajër. Arsyeja e emetimit të NO<sub>x</sub> është përmbajtja e azotit në thëngjill dhe në ajër për djegie. Oksidet e azotit formohen nga reaksioni kimik i azotit dhe oksigjenit nga ajri, që përcillet në vatër. Për oksidimin e azotit nevojitet një nivel i caktuar i temperaturës në vatër dhe një sasi e duhur e oksigjenit.

### 2.5.4 EMITIMI I DYOKSIDIT TE KARBONIT CO<sub>2</sub>

Emetimi i CO<sub>2</sub> është proporcional me përmbajtjen e karbonit në lëndën djegëse dhe kualitetin e derivateve të djegura. Nuk ka metodë të disponueshme komerciale për kapjen e CO<sub>2</sub> prej burimit shkarkues dhe opsioni më i mirë për reduktimin e emetimit të tij është rritja e efikasitetit të pajimeve dhe djegia sa më racionale e lëndëve djegëse. Emetimi i dyoksidit të karbonit në termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova-B" varet nga kualiteti i linjitit dhe operimi.

### 2.5.5 EMITIMI I CO

Ky emetim shkakton rritje të konsumimit të lëndëve djegëse dhe është një tregues i efikasitetit jo të duhur të impiantit. Procesi i djegies është i përcjellë me emetimin e monoksid të karbonit. Emisioni i CO është pasojë e procesit jo të plotë të djegies (procesit të keq të djegies).

### 2.5.6 Vlerat Kufitare të Emisioneve të ndotësve në Impiantet me Djegie të Mëdha (IDM)

Kosova është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKEn), i cili na obligon zbatimin e direktivave të BE-së, në veçanti për mjedisin, përmes zbatimit të Direktivave 2001/80/EC dhe 2010/75/EU për kufizimin e emisioneve të ndotësve të caktuar në ajër nga Impiantet me Djegie të Mëdha (IMD).

PKZE( Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve) synon që të përmbushen vlerat kufitare të emisioneve për SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe Pluhur për kapacitetet ekzistuese, Në tab. Nr.17. janë paraqitur VKE që i obligon Termocentralet e Kosovës dhe DPQ ti nënshtrohet aktiviteteve për rehabilitimin e proceseve teknologjike, me qëllim për ti përmbushur kërkesat që dalin nga Traktati i Komunitetit për Energji (EnCT).se

Ndotësi/Viti	2018	2023	2027
SO <sub>2</sub> (mg/Nm <sup>3</sup> ), për 6% O <sub>2</sub>	400	400	200
NO <sub>x</sub> (mg/Nm <sup>3</sup> ) as NO <sub>2</sub> , për 6% O <sub>2</sub>	500	200	200
Pluhuri (mg/Nm <sup>3</sup> ), për 6% O <sub>2</sub>	50	50	20

Tabela -16 Vlerat Kufitare të Emisioneve për IDM

Sipas; UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) Nr. 07/2021 PËR RREGULLAT DHE NORMAT E SHKARKIMEVE NË AJËR NGA BURIMET E PALËVIZSHME TË NDOTJES

Vlerat specifike Kufitare të Emisioneve për burimet të palëvizshme të djegies për të cilat është dorëzuar aplikacioni për lejen e parë operative me 7 janar 2013 ose më vonë ose pas 7 janari 2014

#### Vlerat Kufitare të emisionit [mg/Nm<sup>3</sup> ]

Lloji I lëndës djegëse	50+100 MW			>100+300MW			> 300 MW		
	SO <sub>2</sub>	NO <sub>x</sub>	Pluhur	SO <sub>2</sub>	NO <sub>x</sub>	Pluhur	SO <sub>2</sub>	NO <sub>x</sub>	Pluhur
Karburant i ngurt	400	300 400 <sup>1)</sup>	20	200	200	20	150 200 <sup>1)</sup>	150 200 <sup>1)</sup>	10

1) Ka të bëjë vetëm me djegien e linjtit të pluhurosuar

Tabela -17 Vlerat Kufitare të Emisioneve


## Raporti Vjetor i Gjendjes në Mjedisit për vitin 2022

**Emisionet totale dhe specifike mesatare vjetore për vitin 2022 të matura dhe të llogaritura për TC "Kosova-A" dhe TC "Kosova-B":**


Termocentrali	Prodhimi (MWh)	Pluhuri			SO <sub>2</sub>			NO <sub>x</sub>			CO <sub>2</sub>		
		(t/vit)	(mg/Nm <sup>3</sup> )	(kg/MWh)	(t/vit)	(mg/Nm <sup>3</sup> )	(kg/MWh)	(t/vit)	(mg/Nm <sup>3</sup> )	(kg/MWh)	(t/vit)	(g/Nm <sup>3</sup> )	(kg/MWh)
A3	831504	227.17	52.7	0.27	1823.8	419.2	2.19	2318.34	537.24	2.79	1161668	240	1397
A4	983354	271.37	54.5	0.28	2610.2	463.9	2.65	3060.91	547.60	3.11	1349808	241	1373
A5	480630	138.0	55.4	0.29	1185	477.4	2.47	1491.38	600.70	3.10	651959	263	1356
∑/Mes.muj TC-A	2295488.2	637	54.0	0.28	5619	450.7	2.45	6871	555	2.99	3163435	245	1378
B1	2148086	2606.9	324.1	1.21	4329	422.1	2.02	5347.04	526	2.49	2441665	245	1137
B2	1902822	2158.2	332.6	1.13	3344	403.6	1.76	4347.05	529.9	2.28	1981954	257	1042
∑/Mes.muj.TC-B	4050908	4765	328.2	1.18	7673	413.2	2.39	9694.10	528	2.39	4423619	258	1091

Tab.18. Emisionet totale dhe specifike mesatare vjetore për vitin 2022 të matura dhe të llogaritura për TC "Kosova-A" dhe TC "Kosova-B":

Në Tabelën 18, janë paraqitur, emisionet mesatare vjetore të llogaritura dhe të matura për vitin 2022



Grafiku Nr.12 Emisionet e grimcave, SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> nga TC "Kosova-A" :



Grafiku.Nr.13 Emisionet e grimcave, SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> nga TC "Kosova-B"

## 2.8 MBETURINAT NË TERMOCENTRALE

Koncepti modern i trajtimit të mbeturinave nënkupton zvogëlimin sa të jetë e mundur prodhimin e tyre dhe të pakësohet sa të jetë i mundur deponimi i tyre. Varësisht nga karakteristikat e mbeturinave, mund të përdoren si nënprodukte në proceset e ndryshme ose si lëndë e parë sekondare. Pas trajtimit, sasia e mbetur e mbeturinës e cila nuk mund të shfrytëzohet më tutje, duhet të deponohet si mbeturinë inerte, pra joaktive. Në kuadër të administrimit të mbeturinave, deponimi mbetet si opsion i fundit. Deponitë duhet të jenë të përgatitura për deponimin e materialeve inerte dhe të tjera, në përputhje me kriteret e parapara sipas akteve ligjore në fuqi të Republikës së Kosovës dhe direktivave të BE-së. Deponitë duhet të kenë evidencën e llojit dhe sasisë së mbeturinave .

### 2.8.1 VAJRAT MBETURINË

Vajrat mbeturinë KEK-u duhet ti grumbullon, ti selekton në bazë të shifrave të katalogut shtetëror për mbeturina, dhe pastaj t'ia shet kontraktorit të licencuar për menaxhimin dhe trajtimin e vajrave mbeturinë.

- Të mbrojnë mjedisin dhe shëndetin e njerëzve nga ndotja me vajra mbeturinë (VM) dhe material mbeturinë të kontaminuar nga vajrat (MMV).
- Të parandalojë, zvogëlojë dhe të kufizojë ndotjen e ujërave, tokës, ajrit si dhe të fuqizojë detyrimet dhe ndalesat për administrimin e vajrave mbeturinë dhe materialit mbeturinë me vajra.

### 2.8.2 Transformatorët me përmbajtje ose dyshime se përmbajnë vajra të kontaminuar.

Në KEK ndodhen transformatorët që përmbajnë vaj me PCB, 21 transformatorë me përbërje vaji me PCB gjenden në Hangarin A2 pranë TC "Kosova B", ndërsa 5 transformator në lokalitetet e TC "Kosova-A". Janë analizuar të 26 transformatorët dhe është konstatuar se përmbajnë PCB mbi normat e lejuar, përmbajnë më tepër se 50 ppm PCB (analiza e vajt e përcakton këtë). Rekomandohet sa ma shpejtë që është e mundur të ndërmarrën të gjitha masat e nevojshme për trajtimin e këtyre pajisjeve në harmoni me legjislacionin në fuqi.

### 2.8.3 MBETURINAT METALIKE DHE MBETURINAT TJERA

KEK-u posedon mbeturina të metalike, duke përfshirë çelikut, hekurin, aluminin, bakrin, së bashku me gomën e hequr nga shiritat transportues të linjtit dhe djerrinës etj. Materialet e lartpërmendura janë kryesisht të lokalizuara në hapësirat e mihjes dhe termocentraleve, ku menaxhohen nga ato subjekte. Këto mbeturina metalike iu shiten kontraktorëve të KEK-ut, të licencuara për trajtimin e mbeturinave metalike dhe mbeturinave tjera.

Ndërsa me mbeturinat sanitare menaxhon Kompania Rajonale "Pastrimi" nga Kastrioti (Obiliqi), sipas kontratës së KEK-ut për menaxhimin e mbeturinave urbane komunale, për largimin apo trajtimin e tyre.

Termocentralet	Mbeturina të hekurit (kg)	Mbeturina të bakrit (kg)	Vajra (lit.)	Shirit transportues (kg)	Sasitë e shitura të skrapit në Vitin 2021 (kg)
TC "Kosova-A"	350 000÷400 000	2 500	0	7 000	-
TC "Kosova-B"	2 327 000	4 000	20 000	0	-
Total	2 677 000÷2 727 000	6 500	20 000	7 000	-

Tab.19. Sasia e mbeturinave metalike në termocentralet e KEK-ut 2022

#### 2.8.4 Mbeturinat me përmbajtje Azbesti

Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 07/2009 - Neni 6, për Administrimin e Mbeturinave që përmbajnë azbest, për parandalimin e ndotjes me azbest nga përpunimi i produkteve që përmbajnë azbest, shfrytëzuesi dhe përdoruesi i këtyre produkteve, e në këtë rast KEK- është i obliguar t'i ndër marrë të gjitha masat e nevojshme sipas dispozitave të veçanta ligjore, që veprimtaria e cila përfshinë shfrytëzimin e produkteve që përmbajnë azbest gjatë aktiviteteve të ndryshme të mos shkaktojë ndotje të mjedisit me fibra apo ndotje të ambientit. Edhe pse është bërë inventarizimi i materialeve që përmbajnë përmbajnë azbest, KEK-u është në proces të përgatitjes së hapësirave deponuese të këtij materiali.

#### 2.8.5 DEPONIA E MBETJEVE RADIOAKTIVE NË KEK

Në zonën e KEK-ut (SK) gjendet objekti për deponimin e materialeve të shpenzuara radioaktive. Objekti (Bunker) është nën administrimin e AKMRrSB, por vazhdimisht monitorohet edhe nga ekipet dhe inspektorët e MPHIL, KFOR-it, FSK si dhe Agjencinë për Emergjencë. FSK-ja realizon matjen e radioaktivitetit përreth objektit dhe në brendësi sipas nevojës. Vlerat e matura janë nën kufijtë e lejueshmërisë së tyre.

Objekti për deponimin e burimeve të shpenzuara radioaktive në hapësirat e ish Gazifikimit është ndërtuar në fund të viteve të 60<sup>ta</sup>, hapësirat deponuese janë të dizajnuara në bazë të numrit të burimeve ekzistues të montuara në Gazifikim. Objekti është i përmasave rreth 16 m<sup>2</sup> dhe i ndërtuar vetëm për nevojën të Gazifikimit. Burimet e shpenzuara radioaktive në Depo janë të regjistruara në listën e burimeve radioaktive të Republikës së Kosovës, monitorohen në vazhdimësi dhe për ndryshimet eventuale raportohen autoritetet.

KEK-u është Korporatë për prodhimin e energjisë elektrike dhe nuk ka kapacitete humane që të merret me burimet e rrezatimit radioaktiv, Ne jemi të interesuar që sa më shpejt që është e mundur të lirohemi nga këto burime të shpenzuara të rrezatimit. Kjo për ne është barrë e madhe dhe angazhohemi që sa më parë të lirohemi nga ky objekt për shkak se është dizajnuar vetëm për mbetjet e shpenzuara radioaktive nga repartet e ish Gazifikimit. Jemi në fazën e Dekomisionimit të ish Gazifikimit dhe duhet menduar edhe për këtë objekt.

#### Pamje nga monitorimi periodik i Objektit nga ekipet e KFOR-it dhe FSK-së



Figura 11. Objektit për deponimin e materialeve radioaktive të shpenzuara

## 2.11 RAPORTI PËRMBLEDHËS PËR TERMOCENTRALET E KOSOVËS

Legjislacioni mjedisor në Kosovë ka për qëllim të rregullojë dhe garantoj të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një ambient me ajër, ujë dhe tokë të pastër, duke e mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën dhe florën si dhe vlerat natyrore dhe kulturore të mjedisit. Prandaj edhe synimi ynë është që ndotja si pasojë e aktiviteteve nga operimi në KEK të jetë në përputhje me legjislacionin mjedisor.

Gjendja më e mirë në mbrojtjen e mjedisit në TC “Kosova-A” ka vazhduar të jetë pas instalimit të fundërruesve elektrostatik të ri dhe sistemit të bartjes hidraulike të hirit në gropat pasive të minierave. Vazhdimi i aktiviteteve operuese në të ardhmen i të dy Termocentraleve do të varet nga performancat mjedisore. Si rrjedhojë, emisioni i gazrave; SO<sub>2</sub>, pluhuri dhe emetimet NO<sub>x</sub> duhet zvogëluar në nivelet e Vlerave Kufitare të Emetimit për Termocentralet me Djegie të Mëdha. Për ti arritur këto VKE duhet investime të theksuara në teknologjinë e reduktimeve mjedisore. Nevojitet menaxhim më i mirë me ujin dhe ujërat industriale, instalimet e pajisjeve për trajtimin e ujërave industriale në pajtim me legjislacionin e Kosovës, udhëzimet e BE dhe praktikat më të mira të mjedisit.

**-Me 29.06.2022, KEK-u në arkivin e MMPHI ka dorëzoi me të dhëna të përditësuar;**

- 1. Aplikacionet për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar për Prodhimin e Qymyrit me Nr.3753/22, dt. 29.06.2022.**
- 2. Aplikacionet për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar për Termocentralin “Kosova-A” me Nr.3753/22, dt. 29.06.2022.**
- 3. Aplikacionet për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar për Termocentralin “Kosova-B” me Nr.3753/22, dt. 29.06.2022.**

**-Po ashtu me 29.06.2022 KEK-u në arkivin e MMPHI ka dorëzoi Dokumentacionin me Nr.3751/22, dt. 29.06.2022:**

- a. Aplikacionin për Leje Ujore-Shfrytëzim i Ujit nga Lumi Llap për Termocentrali “Kosova-A”.**
- b. Aplikacionin për Leje Ujore-Shkarkimi i ujërave prej Termocentralit “Kosova-A”.**
- c. Aplikacionin për Leje Ujore-Shfrytëzim i Ujit nga Hidrosistemi Iber-Lepenc për Termocentrali “Kosova-B”.**
- d. Aplikacionin për Leje Ujore-Shkarkim i ujërave prej Termocentralit “Kosova-B”.**

-Deponia pasive e hirit në TC “Kosova A” po vazhdon të dizajnohet dhe rehabilitohet. Në këto hapësira është në zhvillim Projekti për ngritjen e kapaciteteve për energjinë e ri përtëriteshe - Solare Fotovoltaik . Zona ku do të shtrihet ky Projekt kap sipërfaqen prej 146 hek, 13 ari dhe 14 m<sup>2</sup> .

-Deponia pasive e hirit në TC “Kosova B” edhe më tutje ka mbetur e pa ndryshuar.

-Miniera pasive e Sitnicës përdoret për deponimin e hirit, por me një përkujdesje të vazhdueshme për eliminimin e ndikimeve të mundshme mjedisore për rrethin.



## Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2022

-Programi monitorues duhet realizohet në pajtueshmëri me kërkesat Ligjore Mjedisore dhe udhëzimet administrative mjedisore të Kosovës dhe BE-së për kualitetin e ajrit, kualitetin e ujit dhe emetimet e ndotësve.

-Monitorimet e emetimeve nga oxhaku në ajër nga Termocentralet (i realizuar në TC "Kosova-B"), kërkon investime në mirëmbajtjen e pajisjeve për monitorim të vazhdueshëm, ndërsa në TC "Kosova-A" kërkon investime në instalimin e pajisjeve për monitorim të vazhdueshëm, me qëllim të arritjes së pajtueshmërisë me kërkesat monitoruese nga udhëzimet LCP të BE.

-Pavarësisht rrethanave të cekura më lartë, për sa i përket dy Impianteve me Djegieje të Madhe (TC-vë) "Kosova-A" dhe "Kosova-B", marr parasysh zotime e donatorëve ( Zyrën e BE-së), Strategjinë e aprovuar të Energjisë së Republikës së Kosovës, dhe buxhetin e KEK-ut, gjatë viteve 2022- 2031 do të ndërmerren aktivitetet si në vijim:

### Termocentrali "Kosova-A"

- Bazuar në Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031 dhe buxhetin e aprovuar të KEK-ut, planifikohet që gjatë vitit 2024 të filloi rindërtimi i njësisë A3. Si rezultat i këtij investimi pritet që në vitin 2025 emisionet e PM, NO<sub>x</sub> dhe SO<sub>2</sub> të jenë në kufij të lejuar sipas PKZE.

- Bazuar ne Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031, planifikohet që deri në vitin 2024 do të vendoset për rindërtimin e njësisë A4. Gjatë vitit 2026 të filloi rindërtimi njësisë A4 ku do të përfshihet edhe reduktimi i emisioneve të PM, NO<sub>x</sub> dhe SO<sub>2</sub>. Si rezultat i këtij investimi pritet që në vitin 2026 emisionet e PM, NO<sub>x</sub> dhe SO<sub>2</sub> të janë në kufij të lejuar sipas PKZE për vitin 2027.

- Pas realizimit të investimeve të lartë cekura (njësia A3 dhe njësia A4) njësia e tretë do të dekomisionohet ( A5).

- Për fazën e parë të realizimit të këtij projekti ( njësinë A3) janë paraparë 120,000,000 €, të shpërndarë për tre vite ( 2023-2025).

### Termocentrali "Kosova-B"

- Projektet e planifikuar të karakterit mjedisore në Termocentralin "Kosova-B" si:

1. Fundërruesit Elektrostatik për njësinë B1 dhe njësinë B2,
2. Pajisjet për De-NO<sub>x</sub>-im për njësinë B1 dhe njësinë B2, dhe
3. Impianti për trajtimin e ujerave te shkarkuara (Ujërat industriale, sanitare, ujerat e zeza dhe ujerat atmosferike).

Fillimisht gjate vitit 2023 do te realizohet projekti investiv i delatimeve që do të mundësoi fillimin e punimeve për ndërhyrje investive për zvogëlim e oksideve të azotit ( de-NO<sub>x</sub>) në të dy njësitë ( B1 dhe B2).

-Bazuar në informatën nga Zyra e BE-ë në Kosove, gjatë vitit 2024 do të realizohet projekti për ndërtimin e Fundërruesit Elektrostatik(FES) dhe vendosja e pajisjeve për DeNO<sub>x</sub>-

## Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2022

im në Njësinë B2. Nga tetori i vitit 2024 njësia B2 pritet të operoi në përputhje me kufijtë e lejuar nga PKZE të Republikës së Kosovës.

-Bazuar në informatën nga Zyra e BE-ë ne Kosove, gjatë vitit 2025 do të realizohet projekti për ndërtimin e Fundërruesit Elektrostatik(FES) dhe vendosja e pajisjeve për De-NOx-im në Njësinë B1. Nga tetori i vitit 2025 njësia B1 pritet të operoi në përputhje me kufijtë e lejuar nga PKZE të Republikës së Kosovës.

-Për sa i përket SO<sub>2</sub> kanë filluar aktivitetet përgatitore për draftin e Dosjes se Tenderit. Në ndërkohë KEK është duke aplikuar për financim të këtij investimi ne BE ( IPA 2024). Ne çfarëdo rasti pritet që ky investim të përfundoj dhe emisionet e SO<sub>2</sub> të janë në kufij të lejuar me PKZE në fund të vitit 2027.

-Impianti për trajtimin e ujërave shkarkuese(Ujërat industriale, sanitare, ujerat e zeza dhe ujerat atmosferike) në Termocentrali "Kosova-B". BE ka angazhuar UNOPS për të përgatitur propozimi final të projektit dhe finalizimin e dosjes së tenderit. Projekt është i kushtëzuar nga BE me projektin e financuar nga KEK për Kthimin e ujërave nga depnia e hirit në Mirash e i cili për momentin është pezulluar për shkak të një ankese në OSHP.

**“Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës”**

Faza e dytë e “Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës” Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA);

Masat e kontrollit të ndotjes së ajrit për TC-të; Masat për përmirësimin e efikasitetit të mbledhjes së pluhurit të FES-it duke zbatuar funksionimin e Kontrollit të Energjizimit me Ndërprerje të FES-it në Termocentralin “Kosova-A” çështje nga Projekti i mëparshëm dhe realizimi i aktiviteteve të paraqitura si më poshtë:

- a. Aktivitetet e Masave të kontrollit të ndotjes së ajrit për TC
- b. Shqyrtimi i masave për rehabilitimin e pajisjeve për përmirësimin e operimit të FES për të qenë në pajtueshmëri me Lejen MI. Në periudhën e parë do të konfirmohet gjendjen e Pllakave drejtuese në hyrje (pllakat drejtuese për kontrollin e rrjedhës brenda FES-it) që është propozuar dhe rekomanduar për zbatim për palën kosovare në Projektin e mëparshëm dhe do ta përgatisë zbatimin e kontrollit të energjizimit me ndërprerje të FES-it.

Pas përfundimit të Aktivitetit , JET-i do të ofrojë këshilla teknike për TC “Kosova-A” për përmirësimin ose rinovimin e pajisjeve të FES-it në përputhje me lejen MI.

**2.3 Vlerësimi i performancës së kontrollit të energjizimit të FES-it**

Në periudhën e parë, pala kosovare do të negociojë me prodhuesin e FES për të kërkuar dërgimin e inxhinierëve për ta mbështetur futjen në funksion të e kontrollit të energjizimit me ndërprerje të FES-it. Udhëheqësi i Projektit do të konfirmojë dhe këshillojë për ecurinë e këtij koordinimi.

Në periudhën e dytë, do të futen në funksion dhe operohen masat e kontrollit të energjizimit me ndërprerje për FES. Para dhe pas aplikimit të masave të kontrollit të energjizimit me ndërprerje të FES-it, ekipi i matjes së gazit të shkarkuar të TC-ve i mbështetur nga JET-i do të kryejë matjen e gazit të shkarkuar dhe do të vlerësojë në mënyrë sasiore efektin e masave.

Në kuadër të Projektit “Zhvillimi i Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit”. KEK-u është përfitues i teknologjisë për matjen e gazit të shkarkuar. Pajisjet nga hapësirat e IHMK në hapësirat e KEK-ut, Divizionit Termocentrali “Kosova-A” janë barture me 17.05.2022.



Figura 12 Pajisjet donacion për matjen e gazrave të shkarkuar nga burimet e palëvizshme.

Me vendimin Nr. 4152 të datës 22.07.2022 formohen Grupet punues për realizimin e Projektit të mbështetur nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA); “Projekti i Zhvillimit të Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës” faza e dytë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të stafit të MMPHI Institucioneve relevante të Republikës së Kosovës për fushën përgjegjësisë së tyre. Në kuadër të grupit punues për Matjes e Gazrave nga burimet e palëvizshme përfshihen edhe Sabri Simnica koordinator Grupi, Kastriot Abazi, Flakërim Krasniqi, Zoja Imeri dhe Florent Tahiri.

Me 16, gusht 2022, Grupi për matjen e gazrave të shkarkuar nga oxhaku i njësisë A3 në Divizionin Termocentrali “Kosova-A” ka realizuar matjet e gazrave të shkarkuar dhe pluhurit. Po ashtu Me 11, nëntor 2022, Grupi për matjen e gazrave të shkarkuar nga oxhaku i njësisë B1 në Divizionin Termocentrali “Kosova-B” ka realizuar matjet e gazrave të shkarkuar dhe pluhurit. Raportet detale të gjetjeve gjatë matjeve do të paraqiten nga koordinatori i Grupit Punues .



Figurat 13,14 Pamjet gjatë matjeve të pluhurit dhe gazrave shkarkuese në TC-A dhe TC-B

### 3.0.GJENDJA MJEDISORE NË DPQ-2022

#### 3.1 HYRJE

Në këtë Raport mungojnë të dhënat e monitorimit të ndikimeve mjedisore në DPQ(Divizionin e Prodhimit të Qymyrit); Monitorimi i ujit ,ajrit, tokës, zhurmës vibrimeve, florës, faunës dhe mbeturinave (vajrat). Monitorimi i këtyre ndikimeve mjedisore në mungesë të një Operatori nuk kemi arritur ta realizojmë përveç mbeturinave dhe shkarkimit të ujërave për të cilat është raportuar nga departamentet përkatëse që operojnë në kuadër të DPQ.

Ne këtë raport janë të prezantuar edhe parametrat klimatik siç janë; të reshurat dhe temperatura, të monitoruara me pajisjen meteorologjike Vantage PRO2.




Fig. 15 Imazhi i skemave të vendmostrimeve të ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe shkarkues të parapara për monitorim në DPQ.



Fig.16 Imazhi i ujërave shkarkues nga Miniera - DPQ të parapara për monitorim në L. Drenica dhe L. Sitnica.


### Sasitë e ujërave të shkarkuar nga miniera

Sasia e ujit( $m^3$ ) të shkarkuar nga Miniera në pikat shkarkuese si dhe totali – 2022.

Nr.	Vendi shkarkimit	Simboli	vell. ujit shkarkues ( $m^3$ ) - 2022
1	S.J.P Grabovc - L.Drenice	M - 4	612615.15
2	Mesmihje - L.Sitnice	M - 11*	287845.65
3	SJP- Hade ( $m^3$ )- L.Drnice	M - 1	198603.9
4	<b>TOTALI</b>		<b>1099064.7</b>

Tab.20 Sasia e ujit( $m^3$ ) të shkarkuar nga Miniera në pikat shkarkuese si dhe totali – 2022.

Diagrami i ujit të shkarkuar nga Miniera në pikat e shkarkimit dhe totali i ujit të shkarkuar për vitin 2022.



Grafiku 14 sasitë e ujit të shkarkuar nga Miniera në pikat e shkarkimit dhe totali i ujit të shkarkuar për vitin 2022.

### 3.10.MONITORIMI I V.M, M.M.V DHE MBETURINAVE TJERA

Menaxhimi i mire i vajrave mundëson ruajtjen e mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndotja me vajra mbeturinë (VM) dhe material mbeturinë me vajra(M.M.V). Vendosjen dhe funksionimi e sistemit të përshtatshëm dhe të sigurt mjedisor për administrimin dhe kontrollin me vajra , VM dhe MMV. Të parandalojë, zvogëlojë , kufizojë ndotjen e ujërave, tokës, ajrit si dhe të fuqizojë detyrimet për menaxhimin e mire të vajrave mbeturinë dhe materialit mbeturinë me vajra.

Informatat merren nga departamente përkatëse të cilat operojnë me vajra.

Sasia e vajrave të grumbulluara, yndyrës dhe baterive gjatë muajve dhe totali i tyre për vitin 2022 në DPQ.

Viti		Mbeturinat e grumbulluara gjatë vitit 2022	
Muajt	vajra(l)	Yndyrë(kg)	Bateri(copë)
Janar	700	0.0	0.0
Shkurt	260	0.0	0.0
Mars	410	0.0	0.0
Prill	640	0.0	0.0
Maj	510	0.0	0.0
Qershor	540	0.0	0.0
Korrik	0	0.0	0.0
Gusht	1090	0.0	0.0
Shtator	490	0.0	0.0
Tetor	630	0.0	0.0
Nëntor	730	0.0	0.0
Dhjetor	850	0.0	0.0
Mesatare	6850	0.0	0.0

Tab. 21 Sasia e vajrave të grumbulluara, yndyrës dhe baterive gjatë muajve dhe totali i tyre për vitin 2022 në DPQ.

Konkluzion ;sipas tabelës 21 ,sasia gjithsej e vajrave të grumbulluara gjate viti 2022 është 6850 (l), të cilat janë të vendosura në fuqi.

### 3.11. KUSHTET KLIMATIKE RESHJET DHE TEMPERATURA GJATË VITIT 2022

Reshjet gjate vitit 2022 te monitoruara dhe evidentuara me instrumentin Vantage PRO2.Instrumenti - Vantage PRO2 , jane te vendosur ; Stac. Meteos ne objektin pranë INKOS, Stac. Hade ne shpatin lindor te minierës se SJP dhe Stac. Grabovc ne shpatin perëndimor te minierës. Ne baze te rezultateve muaji më të reshura më të mëdha është Nëntori me 116.1(mm), ndërsa muaji me pak te reshura është Tetori me 3.6 (mm). Monitorimi është bere stac. Meteos ndërsa stac. Hade dhe Grabovc kemi pas ne disa raste ndërprerje te informatave për shkak problemeve teknike. Lartësia mesatare mujore e te reshurave për këta muaj te vitin 2022 arrin në 38.66(mm), kurse sasia e të reshurave vjetore arrin 463.9(mm) pa llogaritur te reshurat e ditëve qe mungojnë informatat.

2022	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
<b>Reshjet.</b>	15.5	14.2	15.5	49.8	26.2	47.8	36.8	28.2	52.1	3.6	116.1	58.1

Tab. 22 Niveli i reshjeve gjatë muajve t; viti 2022



Grafiku 15 Lartësia mesatare mujore e të reshurave për vitin 2022 Temperatura - DPQ




## Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2022

Vlerat mesatare, maksimale dhe minimale në stacionet monitoruese në DPQ.

Muaji	Meteos stacioni Inxhiniering-temp. (°C) 2022		
	Mesatare	maxsimale	minimale
Janar	-0.8	16.0	-15.3
Shkurt	2.9	12.8	-6.9
Mars	3.5	20.0	-10.2
Prill	9.3	24.5	-3.0
Maj	16.5	32.0	0.9
Qershor	21.3	33.8	9.7
Korrik	21.6	35.1	7.8
Gusht	20	31.1	10.7
Shtator	17.1	28.2	8.6
Tetor	12.1	23.4	6.0
Nëntor	7.8	23.3	-1.9
Dhjetor	3.5	16.1	-5.9
Mesatare	11.23	35.1	-15.3

Tab.23 vlerat mesatare, maksimale dhe minimale në stacionet monitoruese në DPQ.


Lakoret e temperaturave me., max. dhe min. në Stac. Monitoruese në DPQ – 2022.



Grafiku 16 Lartësia mesatare mujore e temperaturave për vitin 2022

## Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2022

Temperatura është monitoruar me instrument Vantage PRO2, temperatura maksimale vjetore ka qene 35.1°C, vlera minimale ka qene -15.3°C ndërsa ndryshimi i temperaturës, mesatare vjetore ka qene 11.23°C.



Grafiku 17 Lartësia mesatare mujore e temperaturave për vitin 2022

### PERFUNDIM

Dëmtimi i mjedisit	Minierat sipërfaqësore
Dëmtimet e sipërfaqes së terrenit gjatë eksploatimit	M.S Sibovc - JP
Ndotja e ajrit-IMISIONI	
Ndotja e ajrit-EMISIONI	
Ndotja e ujërave	Nuk ka pas monitorim
Ndotja nga zhurma	
Flora - Fauna	
Vibrimet	
Dëmtimi i sipërfaqes së terrenit pas eksploatimit	

V - i vogël; M-mesatar; L- i lartë

#### 4.0. RAPORT PËRMBLEDHËS I AKTIVITETEVE VJETORE TË NJËSISË PËR MENAXHIM TË PROJEKTEVE MJEDISORE DHE RIKULTIVIM TË TOKAVE PËR VITIN 2022 FUSHËVEPRIMI DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE E NJMPMRT

##### FUSHËVEPRIMI DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE E NJMPMRT

Aktivitetet e NJMPRT zhvillohen në funksion të zbatimit të politikave mjedisore të KEK-ut, të orientuara drejt përmbushjes së obligimeve ligjore në fushën e mjedisit, krijimit të një mjedisi të qëndrueshëm dhe miqësor me rrethin, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e performancës së KEK-ut në aspektin mjedisor.

Aktivitetet e NJMPMRT-ës janë të përqendruara në rehabilitimin dhe ri kultivimin e tokave të degraduara nga aktivitetet minerare ,aktivitetet në termocentrale ,trajtimin e materialeve dhe mbetjeve të ngurta lëngëta dhe mbetjeve të rrezikshme të gjeneruara si rezultat i aktiviteteve minerare dhe industriale në KEK.

Në aspektin organizativ Njesisë për Menaxhimin e Projekteve Mjedisore dhe Ri kultivimin e Tokave, përbehet nga dy departamente :

Departamenti për Pastrimin dhe Ri kultivimin e Tokave dhe

Departamenti i Dekomisionimit dhe Materieve të Rrezikshme

##### Departamenti për Pastrimin dhe Ri kultivimin e Tokave

Spektori i Mjedisit, Drenazhimit dhe Infrastrukturës, është i angazhuar në mirëmbajtjen e objekteve, pastrimin e hapësirave, rrugëve, rrethojave, kanaleve kulluese, pesetave, mbeturinave, pastrimet e shtratit të prroit dhe hapja e mini liqenit në Parkun e KEK-ut.

Në tri raste gjatë vitit ka realizuar dhurim vullnetar të gjakut për QKKTGJ.



Pamje e bllokimit të rrugës "Ali Maloku" në Dardhishtë nga thyerja e plepit dhe pastrimi i saj.

## Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2022



Pamje e pastrimit te kanaleve e mbeturinave brenda oborrin e DPRT-së.



Pamje e pastrimit të kanaleve dhe mbeturinave afër rrugës së fshatit Dardhishtë.



## Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2022

Pamje e aktiviteteve në parkun KEK II



Pamje e rregullimit të rrugës nga DPRT deri të rruga Obiliq-Fushë Kosovë



Pamje e pastrimit të terrenit në Parkun KEK II

Pamje e hapjes së kanalit në plantacionin "Arbëria"

## Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2022



Pamje e aksionit të dhurimit të gjakut 2022.



Pamje e pastrimit të shkurreve në oborrin e TC-A-së nga hyrja zyrtare 04



Pamje e pastrimit mbushjes dhe planimit të terrenit në Parkun KEK II

## Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2022



Pamje e pastrimit të rrugës dhe trotuarit nga IMP deri të hyrja zyrtare 05 të seperacioni i TCA-së.



Pamje e rregullimit të shtratit të lumit Sitnicë

### Sektori i Ri kultivimit

Punët dhe aktivitetet kryesore në sektorin e Ri kultivimit janë zhvilluar në: Mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta të objekteve të KEK-ut ;Kositjen e barit me mallqer dhe me kosa, mbushje me dhe e terrenit dhe rrafshimi i sipërfaqeve, krasitja e degëve të thata të pishave, gurët dhe hedhurinat e ndryshme, ujitjen e fidanëve, prashitjen, prerja, tubimi dhe bartja e degëve, shkurreve dhe pipave në terrenet, krasitja e murit të gjelbër etj.

Janë mbjellë 691 fidane në parkun KEK II.

Mbjellja e fidanëve nga KEEP IT GREEN në plantacionin e Lismirit – donacion i EULEXIT dhe Agjensionit të Pylltarisë rreth 2000 fidanë pishë në Lismir.

Monitorimi i plantacioneve:

1. Plantacioni në parkun KEK-II.
2. Plantacioni KR\_2, në Kala, Bardh i Madh
3. Plantacioni SR\_1, në d. Jugu në Lismir.
4. Plantacioni "Arbëria" në Dardhishtë.

Nr.	Nomenklatura shkencore	Numri i fidanëve
1	Tilia europaea	92
2	Pinus nigra	92
3	Acer Platanoides	92
4	Acer negundo (Flamingo)	83
5	Liquidambar styraciflua	83
6	Gingo babiloa	83
7	Prunus Cerasifera"Nigra"	110
8	Picea Pungens"	28
9	Chamaecyparis Arizona	28
	Gjithësejtë	<b>691</b>

Tab. 24 Fidanët e reja të mbjellura në vitin 2022 në parkun KEK II.



## Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2022

Nr.	Lloji i bimëve të mbjella		Sasia e bimëve të mbjella		te zhvilluara
	Lloji	Emri latin	Vjeshtë/pranverë 2010/2011	Vjeshtë 2011	
2	Bung turk	Quercus cerris	10500	7000	2500
3	Qarr	Quercus petrea	11000	7500	3500
4	Bredh i zi	Pinus nigra	4500	4000	0
5	Bung hungarez	Quercus frainetto		5,000	4200
6	Bung	Quercus Pubescens		7500	6050
7	Rubinia	Robinia psuedoacacia		9000	5500
8	Plep i bardh	Populus Alba		4000	3360
9	Kulumri	Prunus spinosa		3000	2520
10	Murriz	Cretaeagus mongyna		3000	2520
11	Kaqë	Berberis vulgaris		1000	840
12	Thana	Cornus mas		1000	840
Gjithsej			<b>26000</b>	<b>52000</b>	<b>31830</b>

Tab.25 Fidanët në plantacionin KR-2, deponinë e djerrinës Kalaja

Nr.	Lloji i fidanëve	Numri i fidanëve
1	Bagrem	25597
2	Bung	8449
3	Pajë	2804
Gjithsej		<b>36850</b>

Tab.26. Fidanët në plantacionit SR-1, deponia e djerrinës Jugu

Nr.	Lloji	Sasia e fidanëve të mbjella	Gjithsej fidanë në plantacion
1	Plep	502	502
2	Bredh	1499	1299
3	Gështenjë	514	514
4	Rrap	509	509
5	Bliri	500	500
Gjithsejtë		3524	3324

Tab.27 Monitorimi i plantacionit të Dardhishtës

## Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2022

### Ne vazhdim janë pamjet e pastrimit të barojave



### Pamje e pastrimit të barojave në oborrin e TCA-se dhe të autotransporti hekurudhor



Aktivitetet kryesore të DDMRR janë zhvilluar në :

**Monitorim i vazhdueshëm i hapësirës 60 ha të zonës së dekomisionimit në TC “Kosova-A”**

Përkujdesjes për objektet që përmbajnë mbetje të rrezikshme



Foto :Kositja e barojave rreth bunkerit me mbetje radioaktive , brenda rrethojës së metaltë ,me rekomandimin e raportit të dt . 18.05.2022 nga KFOR-i dhe FSK-ja.




Pamje në rregullimin e rrethojës së bunkerit të materieve të rrezikshme të TCA-ja

Bashkëpunim i ngushtë me konsulencën e Zyrës së BE në Kosovë për procesin e dekomisionimit


Hartimin e detyrave projektuese dhe termave të referencës për projektet e trajtimit të mbetjeve që përmbajnë azbest, mbetjeve të ngurta dhe të lëngëta dhe vajrave me përmbajtje të BPK

Përkujdesje për bunkerin me mbetje radioaktive

## Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2022




Faza e parë e projektit për trajtimin e materialeve dhe mbetjeve me përmbajtje të azbestit dhe leshit mineral




Faza e parë-trajtimi i vajrave të transformatorëve me përmbajtje të bifenileve të polikloruara

## Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2022



## Projektet ideore për rehabilitim dhe ri kultivim të tokave



## RAPORTI VJETOR PËR GJENDJEN NË MJEDIS, 2022

Raporti vjetor për gjendjen në mjedis 2022, është përgatitur nga:  
Departamenti i Mjedisit, mbështetur në raportet vjetore të:  
Sektorit të Mjedisit pranë Divizionit të Prodhimit të Qymyrit,  
Sektorit të Mjedisit pranë Divizionit Termocentrali "Kosova-A",  
Shërbimi i Analizave, Termocentrali "Kosova-A",  
Sektori i Mjedisit pranë Termocentralit "Kosova-B",  
Shërbimi i Analizave Termocentrali "Kosova-B",  
Departamentit për Ri kultivimin dhe Pastrimin e Tokave degraduese (DRPT)



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES  
DIVIZIONI SHËRBIMET E KORPORATËS  
DEPARTAMENTI I MJEDISIT  
Rr. "Nëna Terezë" Nr.26

[www.kek-energy.co](http://www.kek-energy.co)

**DEPARTAMENTI I MJEDISIT**



**FALEMINDERIT**  
**DEPARTAMENTI I MJEDISIT**